

“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION

Defending Property, Pursuing Justice

P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA


Phone: +355 33 22 4883 Mobile : +355 68 20 76 736 • E-mail: property.justice@yahoo.com

STRATEGJIA E QEVERISË PËR PRONAT ËSHTË DESHTIM I PROGRAMUAR I DEMOKRACISË. AMBASADORËT JANË TË LUTUR TË MOS HESHTIN

21.07.2012

Qeveria pretendon zgjidhjen përfundimtare të problemit të pronave me Strategjinë 2012-2020, por kjo strategji duhet rishikuar sepse nuk përputhet as me detyrimet kushtetuese dhe as me kërkesat e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Strategjia 2012-2020 shtyn afatet kohore mbyll ciklin e luftës së klasave që filloi në 1945 prej diktatorit komunist dhe mbron korrupsionin postkomunist me pronat. Strategjia është e gabuar pasi e ka fragmentizuar problemin e pronës sipas zërave kadastrale. Legjislacioni për pronat është difektuoz, është haptas në shkëlqje të detyrimeve kushtetuese dhe të drejtës së pronësisë dhe metodologjia e Strategjisë aktuale mbështetur tek kompensimi, mbron përvetësimet që kanë bërë pushtetarët në këto 20 vjet. Çdo pronë që nuk i kthehet subjektit të shpronësuar është një faturë financiare dhe e vetmja zgjidhje në përputhje me nenin 41 të kushtetutës mbetet kthimi fizik i pronës së shtetëzuar tek i zoti. Qeveria dhe Kryeministri Berisha, më parë se ndërtimet e paligjshme duhet të legalizojë dhe të kthejë tek i zoti pronat që kanë zot dhe nuk duhet të përdorin termin ish pronarë për pronarët e ligjshëm, që janë shpronësuar nga diktatura me akte nënligjore të karakterit ideologjik politik. Kthimi nuk ka nevojë për 16 ligje me pengesa e kufizime sipas zërave kadastrale dhe për 8 institucione. Procesi i kthimit bëhet me një ligj të vetëm dhe nga një institucion, duke u bazuar në regjistrat e shtetëzimit komunist, që shteti i disponon. Tokat me të cilat Qeveria me strategjinë aktuale pretendon se i disponon për kompensim të subjekteve të shpronësuar, le tu jepen sipas rastit pseudopronarëve dhe politikanëve për pronat që do t’ju hiqen nga reforma pasi i kanë përfituar padrejtësisht me ligjet e miratuara pas vitit 1991. Prona është bërë burim korrupsioni në rritje për këtë administratë dhe sistem gjyqësor ku mungon themeli dhe drejton korrupsioni. Në këto 20 vjet Shteti me ligje ka nxitur dhe ka kultivuar vesin e vjedhjes dhe kulturën e korrupsionit.

Ligjet dhe gjykatat e shtetit mbrojnë dhe stimulojnë shtetasit të përvetësojnë (vjedhin) pronat e njëri tjetrit. Kjo ka futur konflikt dhe përçarje në popull, shtetasit po kërcënojnë dhe vrasin njëri tjetrin, konflikti dhe krimi është futur edhe brenda familjes. Nga kjo amulli ligjvënësit dhe politikanët që përgjithësisht kanë përfituar prona në zonat turistike mjaftohen me amendime (arnime) pa vlerë të ligjeve ekzistuese dhe kundërshtojnë me çdo kusht reformën për çuarjen e pronës tek i zoti. Respektimi i titujve të pronësisë përbën parakushtin dhe themelin e çdo shteti



“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION


Defending Property, Pursuing Justice

P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 33 22 4883 Mobile : +355 68 20 76 736 • E-mail: property.justice@yahoo.com

ku zbatohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, që në Shqipëri vazhdojnë të shkelen. Shkelja e të drejtave të pronarëve autoktonë, për kushtet e Shqipërisë është sabotimi më i

rëndë i interesave kombëtare. Në këto 20 vjet shteti me pronën po zbaton disa standard dhe ky është “eksperimentim” kriminal, që filloi pas vitit 1991 me terapinë e shokut dhe me frymën e shkatërrimit të pronave “sepse i kishte bërë komunizmi” që vazhdoi me fazën e grabitjes së pronës (private dhe shtetërore). Rruga e gabuar me pronat është bërë gangrena e Shqipërisë. Pasojat e kësaj politike i kuptojnë të gjithë por nuk guxojnë të flasin, analistët e politikës e shmangin; shumë media kanë frikë ti botojnë shkrimet që kritikojnë shkeljen e të drejtës së pronësisë. Çdo shtet dhe në çdo kohë e ka dënuar me ligj zhvatjen, pasurimin e paligjshëm dhe grabitjen. Media vazhdimisht ka raportuar kërcënime me jetë dhe vrasje për një pëllëmbë tokë, apo për një vijë uji, por politikanët e papërgjegjshëm dhe pa shpirt demokratik dhe kombëtar heshtin. Nga Shoqata e pajtimit mbarëkombëtar janë raportuar mbi 6000 vrasje për motive pronësie. Kjo plagë e rëndë po bëhet bashkudhëtare e një tranzicioni që po tejzgjatet njëllor si tranzicioni nga socializmi ngadhënjimtar në komunizëm. Do të jetë kriminale nëse Kryeministri, Qeveria dhe politika nuk do të reflektojë dhe nuk do ta korigjojë këtë strategji, por do tentojë në këtë strategji antidemokratike. Që ti jepet fund fallsitetit demokratik 1991-2012, duhet që pronën, që diktatura me akte nën ligjore e morri padrejtësisht (neni 1 i ligjit 9235), shteti demokratik ka detyrim kushtetues t’ a kthejë me ligj dhe të kompensojë për pronat, që para vitit 1991, janë tjetërsuar për godina banimi, për pronat që janë shfrytëzuar dhe vazhdojnë të shfrytëzohen për nevoja publike. Diktatori i ka ruajtur në Arkivë dokumentat e pronësisë dhe e drejta e pronësisë subjektivit të shpronësuar nuk i është mohuar as në kohën e diktaturës (Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gj. Lartë nr 24 dt.13.03.2002). Strategjia e Qeverisë e konstaton anarkinë titujve të pronësisë, por e maskon shkakun e vërtetë që është neni 8 i ligjit 7501, që e la trashëgim Ramiz Alia. Sipas kësaj strategjie prona e shtetëzuar padrejtësisht nga diktatura pas 29 Nëntor 1944, u trajtua dhe vazhdon të trajtohet si pronë në dispozicion të politikanëve dhe pushtetit. Asnjëherë nuk është analizuar fakti se përse është shkelur afati 3 vjet që përcaktoi neni 181 i Kushtetutës për të rregulluar titujt e pronësisë sipas parimit “e blerë, e dhuruar e trashëguar”, por vazhdojnë të bëhen ligje për të shpejtuar dhe favorizuar legalizimet dhe shkelësit e ligjit, pa bërë dallim se në cilën tokë është ndërtuar në shkelje të ligjit. Nxitet për kompensime, në një kohë kur nuk është bërë ndarja se cilat janë pronat e shtetit dhe cilat janë pronat që shteti i ka grabitur dhe kanë kaluar 20 vjet dhe akoma nuk ka përfunduar procesi i kthimit dhe absurditeti shkon deri aty sa hartat do të saktësohen në vitin 2020. Strategjia e Qeverisë 2012-2020 për pronat është e njëjta me rekomandimet e dhëna prej Bankës Botërore, që e kanë orientuar problemin e pronës në rrugë të gabuar që mohon themelet e demokracisë. Fatkeqsisht kjo rrugë kriminale është financuar nga Banka Botërore, FMN, USAID dhe është favorizuar nga heshtja e disa ambasadorëve dhe e disa institucioneve ndërkombëtare. Vendimi pilot i GJEDNJ (rasti Puto, Muka etj) për kompensimet e pa realizuara, tregoi qartë se Strasburgu nuk do të tolerojë, gabimet dhe papërgjegjshmërinë e lidërshiptarëve shqiptarë me pronat. Në Shqipëri ka humbur besimi tek drejtësia sepse vetë shteti shkel kushtetutën, sepse mos ekzekutimi i vendimeve të gjykatave vendore është një fenomen i shpeshtë, por ka edhe më keq. Avokatura e



“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION

Defending Property, Pursuing Justice

P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 33 22 4883 Mobile : +355 68 20 76 736 • E-mail: property.justice@yahoo.com

Shtetit e mashtron Këshillin e Europës dhe raporton se edhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut janë ekzekutuar, kur ato nuk janë ekzekutuar. Që zullumet e politikanëve me pronat të ndalen, duhet që personat e interesuar të dërgojnë në Strasburg ankesat qoftë për kthime, për kompensime apo mos ekzekutime. Ekzekutimi konsiderohet pjesë e gjyqimit dhe ka shumë mundësi që GJEDNJ të marrë edhe një vendim tjetër pilot për të dënuar shtetin që nuk ekzekuton në kohë vendimet e gjykatës që kanë marrë formë të prerë.

Eshtë koha që B.Botërore dhe veçanërisht Ambasadori i BE, OSBE, SHBA dhe politikanët që duan ti shërbejnë demokracisë dhe Shqipërisë, ta shqyrtojnë seriozisht këtë problem dhe të reagojnë, pa humbur kohë, që këtë vjeshtë prona të mos bëhet pengesa për në BE. Aktualisht Shqipëria është i vetmi shtet antar i NATOs, që shkel të drejtat e njeriut dhe detyrimet kushtetuese për pronën e trashëguar dhe nuk mund të bëhet i vetmi vënd kandidat i BE me këtë të metë absurde. Presim nga Komisioneri i BE, zoti Stefan Füle, ta formulojë qartë dhe prerë prioritetin e kthimit të pronës tek i zoti.

Rrapo Hajredin Danushi

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronesi me Drejtesi”